

Tiranë mund të realizojë edhe mbrojtjen tuaj pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, në lidhje me vërtetimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës tuaj, një procedurë që është e nevojshme të kryhet nëse fëmija juaj nuk është regjistruar brenda afatit 45 ditore nga data e lindjes. Ju nuk duhet të nguroni të regjistroni fëmijët tuaj. Ju duhet t'i jepni atyre mundësinë për të qënë qytetarë të denjë të këtij vendi. Ju duhet t'i lehtësoni ato nga problemet e së ardhmes. Për këto arsyen:

NXITONI
TË REGJISTRONI FËMIJËT TUAJ!
E ARDHMA E TYRE
KËRKON NJË IDENTITET!



Adresa e TLAS
Rr. "Sami FRASHËRI", 4 Kullat, Seksioni III, Ap. 1A, Tiranë,
Shqipëri, Kutia Postare Nr. 69
ose telefononi në numrat:
258 442 & 253114

REGJISTRIMI I LINDJES SË FËMIJËVE NË ZYRAT E GJENDJES CIVILE

JENI TË MIRËPRITUR NË ZYRAT E
SHËRBIMIT LIGJOR FALAS TIRANË, TLAS

TLAS

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË
TIRANA LEGAL AID SOCIETY

REGJISTRIMI I LINDJES SË FËMIJËVE TE GJENDJES CIVILE

Falenderojmë

unicef 1946 - 2006

ROMA EDUCATION FUND

Pë r mbështetjen e dhënë për regjistrimin e fëmijëve në Tiranë dhe për botimin e kësaj fletëpalosje

Çfarë është Gjendja Civile?

Gjendja civile në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji Nr. 8950 Datë 10.10.2002. Sipas këtij ligji, gjendja civile është tërësia e të dhënavë personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin dhe marrëdhëniet personale mes shtetasve shqiptarë. Këto të dhëna shërbejnë për:

- Realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhënie me shtetin dhe shoqërinë,
- Ushtrimin e funksioneve të organeve shtetërore.

Në gjendjen civile të një personi bën pjesë emri, mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, seksi, atësia, mëmësia, vdekja, shpallja i zhdukur dhe fakte të tjera të parashikuara nga ligji.

Në regjistrin e gjendjes civile duhet të regjistrohen të gjitha familjet dhe antarët e saj, të dhënat e secilit anëtar dhe përbërësit e gjendjes civile për secilin anëtar. Regjistrat e Gjendjes Civile ndodhen pranë Zyrës së Gjendjes Civile.

Përse duhet regjistrimi i lindjeve të fëmijëve?

Regjistrimi i fëmijëve i bën ato shtetas shqiptarë duke i dhënë atyre jo vetëm shtetësinë, por edhe të drejtën përtë fituar nga të drejtat dhe lirite politike, ekonomike, sociale dhe kulturore si të gjithë shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë. Duke qënë të regjistruar fëmijët tuaj mund të përfitojnë nga sistemi i përkujdesjes shëndetësore si dhe sistemi i vaksinimit.

Duke qënë të regjistruar fëmijët tuaj mund të përfitojnë nga sistemi i edukimit (arsimimit) parashkollar dhe shkollar. Si të regjistruar, fëmijët tuaj mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe sociale. Duke mos qënë të regjistruar, fëmijët tuaj nuk do të mund të registrohen si të pastrehë. Si të tillë nuk do të përfitojnë nga skemat e strehimit të popullatës së varfër.

Të paregjistruar në Gjendjen Civile, fëmijët tuaj nuk do të mund të registrohen si të papunë kur të mbushin moshën përkatëse dhe nuk do të përfitojnë nga ndihma ekonomike për të papunët. Por, edhe nëse ato do të punojnë, puna e tyre nuk do të registrohet. Mosregjistrimi i punës së tyre, nuk i jep të drejtën e sigurimit shoqëror dhe kur të plaken nuk do të përfitojnë dot pension. Duke mos qënë të regjistruar, fëmijët tuaj nuk kanë shtetësi shqiptare dhe si të tillë nuk kanë do të kenë të drejtën e votës, as të zgjedhin e as të zgjidhen.

Duke mos u regjistruar, fëmijët tuaj nuk do të përfitojnë të drejtën përtu pajisur me pasaportë dhe përtë lëvizur jashtë territorit shqiptar përmotive pune, etj.

Megjithate, duhet te dini se nuk ka diskriminim per shkak seje i paregjistruar.

Regjistrimi i akteve të lindjes

Lindja e personit është një ngjarje natyrore e cila duhet të registrohet pranë Regjistrat Themeltar të gjendjes civile. Anëtarët e rind të familjes kur lindin duhet të registrohen pranë këtij regjistri. Për këtë regjistrim



duhet të kryhen disa veprime shumë të thjeshta të cilat jo vetëm që kërkohen nga ligji por edhe rregullohen prej tij. Akti i lindjes është regjistrimi i faktit të lindjes së personit pranë regjistrat themeltar të gjendjes civile. Ai vërteton ligjërisht faktin e lindjes.

Për plotësimin e aktit të lindjes nevojitet të dorëzohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile dokumentet bazë të lindjes.

Lindjet si fakt, koha e lindjes, vendi i lindjes, sekzi i foshnjës që lind dhe mëmësia e saj vërtetohen me

raport mjekësor të hartuar nga personeli mjekësor ose procesverbal të mbajtur nga autoritete të pranishme siç mund të jenë i ngarkuari i posaçëm i pushtetit vendor, përgjegjësi ose kapiteni i trenit, avionit, anijes gjatë udhëtimit, komandanti i burgut ose i repartit ushtarak apo zyrtarët e përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

Kur lindja e foshnjës ndodh pa praninë e mjekut ose jashtë institucioneve të përmendura më sipër, vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në bazë të raportit të mjekut pasi merr kontakt me nënën dhe fëmijën.

Lindja e shtetasit deklarohet te nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile në vendbanimin e prindërve nga:

1. Prindër të fëmijës,
2. Pjesëtarët madhorë të familjes,
3. Përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarë,
4. Në mungesë të tyre, nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen,
5. Përfaqësuesit e nënës me prokurë notariale.

Deklarimi i lindjes duhet të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e lindjes.

Pa mbarimit te ketij afati lindja konfirmohet vetëm me vendim të gjykatës.

Nëpunësi i Gjendjes Civile pasqyron në aktin e lindjes emrin e fëmijës sipas dëshirës së prindërve me përjashtim të emrave me karakter fyes, imoral apo racist. Çdo kundërshtim ndaj refuzimit të regjistrimit të emrit paraqitet në gjykatë. Fëmija merr mbiemrin e prindërve dhe kur prindër të kanë mbiemr të veçantë, ai merratë të babait.

Kur fëmijës nuk i njihet atësia, atij i vihet mbiemri i nënës. Fëmija jashtë martese merr mbiemrin e vajzërisë së nënës. Nëse prindër të fëmijës kanë vdekur, nuk janë në gjendje mendore a fizik e apo nuk gjenden, emri i caktohet nga pjesëtarët e familjes apo të afërmit e tjerë. Në rast të mos regjistrimi të fëmijës që lind, prindër, të afërmit ose personat e autorizuar nga ligji, duhet të nisin procedurën e regjistrimit. Në rast se kjo procedurë nuk ndiqet brenda afatit 45 ditëve nga data e lindjes së fëmijës, atëherë vërtetimi i faktit juridik të lindjes mund të bëhet pranë gjykatës së shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi. Mosdeklarimi i lindjes së fëmijës përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Nëpunësi i Gjendjes Civile. Gjoba është në masën 2000 Lekë. Kundër masës administrative mund të ushtrohet ankim pranë Prefektit brenda 10 ditëve, i cili duhet të shprehet për këtë masë brenda 15 ditëve. Kundër vendimit të Prefektit ushtrohet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

Çfarë ju ofron TLAS?

Në rast se ju nuk keni dijeni për procedurën e regjistrimit të fëmijëve tuaj në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile, ju mund të kërkon pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë të gjithë informacionin e nevojshëm, si dhe të ndiqni këtë procedurë falë asistencës së tij. Të gjitha shërbimet janë falas. Përveç këshillimit të specializuar, Shërbimi Ligjor Falas